L I G J
Nr.8849, datë 27.12.2001

PËR RATIFIKIMIN E "PROTOKOLLIT PËR UJIN DHE SHËNDETIN, SIPAS KONVENTËS SË VITIT 1992, PËR MBROJTJEN DHE PËRDORIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE DHE LIQENEVE NDËRKOMBËTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli për ujin dhe shëndetin, sipas Konventës së vitit 1992, për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare" të 18 qershorit 1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3210, datë 31.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PROTOKOLL
PËR UJIN DHE SHËNDETIN PËR KONVENTËN E VITIT 1992 MBI MBROJTJEN DHE PËRDORIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE DHE LIQENEVE NDËRKOMBËTARE

Palët në këtë Protokoll,

Të kujdesshëm që uji është thelbësor për mbështetjen e jetës dhe sigurimi i tij në sasi dhe cilësi të mjaftueshme për plotësimin e nevojave bazë të njerëzimit është një kërkesë e domosdoshme për shëndet më të mirë dhe për një zhvillim të qëndrueshëm,

Duke njohur përfitimet në shëndetin human dhe mirëqenien që rrjedhin nga uji i shëndetshëm dhe i pastër, e një mjedisi ujor harmonioz dhe me funksionim të përshtatshëm,

Të ndërgjegjshëm që ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore janë burime me një kapacitet të kufizuar ripërtëritës nga ndikimi negativ i aktivitetit human, në sasi dhe cilësi, që çdo mungesë e respektimit të kufijve mund të rezultojë në efekte të kundërta, afatshkurtëra apo afatgjata, në shëndet dhe mirëqenie të atyre që mbështeten në cilësinë e këtyre burimeve dhe si konsekuencë menaxhimi i qëndrueshëm i ciklit hidrologjik është thelbësor për plotësimin e nevojave humane dhe mbrojtjen e mjedisit,

Të ndërgjegjshëm në pasojat për shëndetin publik të reshjeve në sasi e cilësi, të mjaftueshme për të plotësuar nevojat humane bazë dhe efektet serioze të reshjeve, në veçanti në kontigjentin e njerëzve më të dobët dhe me disavantazh nga ana sociale,

Të ndërgjegjshëm që parandalimi, kontrolli dhe pakësimi i sëmundjeve me origjinë nga uji janë detyra të rëndësishme dhe urgjente, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet kooperimit në të gjitha nivelet dhe midis gjithë sektorëve, brenda vendit dhe midis shteteve,

Të ndërgjegjshëm, gjithashtu, që mbikëqyrja e sëmundjeve me origjinë nga uji dhe vendosja e sistemit të hershëm të paralajmërimit dhe sistemit të përgjigjes janë aspekte të parandalimit, kontrollit dhe uljes së sëmundjeve me origjinë nga uji,

Të bazuar në konkluzionet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (Rio de Zhanerio, 1992), në veçanti në Deklaratën e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin dhe

zbatimin e mëtejshëm të Agendës 21 (Nju Jork, 1997) dhe në vendimin konsekuent të Komisionit për Zhvillimin e Qëndrueshëm mbi menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave të ëmbla (Nju Jork, 1998),

Të frymëzuar nga klauzolat përkatëse të Konventës së 1992 për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare dhe duke theksuar nevojën për të inkurajuar aplikimin më të gjerë të këtyre klauzolave dhe për të plotësuar Konventën me masa të tjera për mbrojtjen e shëndetit publik,

Duke marrë parasysh Konventën e 1991 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar, Konventën e 1992 mbi Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale, Konventën e Kombeve të Bashkuara të 1997 mbi Ligjin e Mospërdorimit për Lundrim të Ujërave Ndërkombëtare dhe Konventën e 1998 mbi të Drejtën për Informim, dhe Pjesëmarrjen në Vendimmarrje dhe të Drejtën për Gjykim për Problemet Mjedisore,

Më tej, duke marrë parasysh gjithashtu principet, objektivat dhe rekomandimet e Kartës Europiane të 1998 mbi Mjedisin dhe Shëndetin, Deklaratën e Helsinkit mbi Mjedisin dhe Shëndetin dhe deklaratat ministrale, rekomandimet dhe Rezolutën e procesit "Mjedisi për Europën",

Duke njohur bazën e qëndrueshme dhe përkatësinë e iniciativave të tjera mjedisore, instrumentet dhe proceset në Europë, si dhe përgatitjen dhe implementimin e Planeve Kombëtare të Veprimit për Mjedisin dhe Shëndetin dhe Planeve Kombëtare të Veprimit për Mjedisin,

Duke përshëndetur përpjekjet e ndërmarra tashmë nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën dhe Zyra Rajonale për Europën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për forcimin e kooperimit bilateral dhe multilateral për parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve me origjinë nga uji,

Të inkurajuar nga shumë shembuj të arritjeve pozitive nga shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën dhe shtetet anëtare të Komitetit Rajonal për Europën të Organizatës Botërore të Shëndësisë në uljen e ndotjes, mirëmbajtjen dhe përtëritjen e mjediseve ujore, të afta për mbështetjen e mirëqënies dhe shëndetit human,

Ranë dakord si vijon:

Neni 1
Objektivi

Objektivi i këtij Protokolli është të promovojë në të gjitha nivelet përkatëse, në kontekstin nacional, si dhe atë ndërkufitar dhe ndërkombëtar, ruajtjen e mirëqenies dhe shëndetit human, të individit dhe kolektivit, brenda kuadrit të zhvillimit të qëndrueshëm; duke përmirësuar menaxhimin e ujit, duke inkluduar ruajtjen e ekosistemeve të ujit dhe nëpërmjet parandalimit, kontrollit dhe reduktimit të sëmundjeve transmetuar përmes ujit.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli:

1."sëmundje të lidhura me ujin" nënkupton çdo efekt negativ në shëndetin human, të tilla si vdekje, paaftësi, sëmundje ose çrregullime, të shkaktuara direkt ose indirekt nga konditat ose ndryshimet në sasi apo cilësi të ndonjë burimi ujor;

2. "ujë i pijshëm" nënkupton ujin që përdoret, ose parashikohet të jetë i përdorshëm nga njerëzit për pirje, gatim, përgatitje të ushqimeve, higjienë personale ose qëllime të ngjashme;

3. "ujë nëntokësor" nënkupton ujin që është nën sipërfaqen e tokës në zonën e saturuar dhe kontakt direkt me tokën apo nëntokën;

4. "ujëra të mbyllura" nënkupton trupa ujore të krijuara artificialisht të ndara nga ujëra të ëmbla sipërfaqësore ose ujërat bregdetare, brenda ose jashtë një ndërtese;

5. "ujëra ndërkufitare" nënkupton ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore, të cilat përshkojnë ose janë të lokalizuara në kufijtë midis dy ose më shumë shteteve; kur ujërat ndërkufitare rrjedhin direkt në det, këto ujëra ndërkufitare përfundojnë në linjë të drejtë;

6. "efektet ndërkufitare të sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet ujit" nënkupton çdo efekt të rëndësishëm mbi shëndetin human, si vdekje, paaftësi, sëmundje apo çrregullime, në një zonë nën juridiksionin e një pale, të shkaktuara direkt apo indirekt nga konditat ose ndryshimet në sasi ose

cilësi, nga ujërat në një zonë nën juridiksionin e një Pale tjetër;

7. “ndikimi ndërkufitar nënkupton çdo ndikim të rëndësishëm negativ në mjedis që rezulton nga një ndryshim në konditat e ujërave ndërkufitare të shkaktuara nga aktiviteti human, origjina fizike e të cilit është vendosur tërësisht ose pjesërisht në një zonë nën juridiksionin e një Pale në Konventë, ndaj një zone nën juridiksionin të një Pale tjetër të Konventës. Efekte të tilla në mjedis përfshijnë efekt në sigurinë dhe shëndetin human, florën, faunën, tokën, ajrin, ujin, klimën, peisazhin dhe monumentet historike ose struktura të tjera fizike apo ndërveprime midis këtyre faktorëve; ato gjithashtu inkludojnë efektet në trashëgiminë kulturore ose konditat socio-ekonomike që rezultojnë nga ndryshimet e këtyre faktorëve;

8.“saniteti” nënkupton grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe asgjësimin ose ripërdorimin (riciklimin) e mbeturinave humane ose ujërat e zeza nëpërmjet sistemeve kolektive ose nga instalimet që i shërbejnë godinave të veçanta;

9. “sistem kolektiv” nënkupton:

(a) një sistem për furnizim me ujë të pijshëm të një numri godinash ose ndërmarrjesh; dhe/ose

(b) një sistem për sigurimin e sanitetit, i cili i shërben një numuri godinash ose ndërmarrjesh dhe, kur është e përshtatshme, siguron gjithashtu grumbullimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin ose ripërdorimin e ujërave të shkarkimeve industriale, qoftë objekt i sektorit publik, ndërmarrje private ose një partneritet midis dy sektorëve;

10. “plani i administrimit të ujit” nënkupton një plan për zhvillim, administrim, mbrojtjen dhe/ose përdorimin e ujit brenda një territori ose akuiferi nëntokësor, duke përfshirë mbrojtjen e ekosistemeve të lidhura me to;

11. “publiku” nënkupton një ose më shumë persona fizikë ose juridikë dhe, në përputhje me praktikën dhe legjislacionin nacional, shoqatat, organizatat apo grupet e tij;

12. “Autoriteti Publik” nënkupton:

(a) qeverinë në nivel kombëtar, rajonal dhe nivele të tjera;

(b) personat fizikë ose juridikë që kryejnë funksione administrative publike në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke përfshirë detyra specifike, aktivitete ose shërbime në lidhje me mjedisin, shëndetin publik, sanitetin, administrimin e ujit ose furnizimin me ujë;

(c) çdo person tjetër fizik apo juridik që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose siguron shërbime publike, nën kontrollin e një organi ose personi që hyn në nënparagrafët (a) ose (b) më lart;

(d) institucionet e çdo organizate të integrimit ekonomik rajonal referuar në artikullin 21 që është Palë.

Ky definicion nuk përfshin njësitë ose institucionet që veprojnë në kapacitet juridik ose legjislativ.

13. “lokale” i referohet të gjitha niveleve përkatëse të njësive territoriale nën nivelin e Shtetit;

14. “Konventë” nënkupton Konventën mbi Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, bërë në Helsinki në 17 mars 1992;

15. “takimi Palëve të Konventës” nënkupton organizimin e vendosur nga Palët në Konventë, në përputhje me nenin 17;

16. “Palë” nënkupton, derisa nuk përcaktohet ndryshe, një organizatë shtetërore ose rajonale të integrimit ekonomik rajonal të referuar në nenin 21, e cila është miratuar të jetë e lidhur nga ky Protokoll dhe për të cilën ky Protokoll është në forcë;

17. “takime të Palëve” nënkupton organizimin e vendosur nga Palët në përputhje me nenin 16.

Neni 3

Sferat e veprimit

Klauzolat e këtij Protokolli do të zbatohen në:

(a) ujërat sipërfaqësore të ëmbëla;

(b) ujërat nëntokësore;

(c) grykderdhjet;

(d) ujërat bregdetare të cilat përdoren për pushime ose për prodhimin e peshqve prej akuakulturës ose për prodhimin apo mbledhjen e molusqeve;

(e) ujërat e mbyllura të destinuara për banjo;

(f) ujërat për transport, trajtim ose furnizim;

(g) ujërat e ndotura të destinuara për transport, trajtim dhe shkarkim ose ripërdorim.

Neni 4
Klauzolat e përgjithëshme

1. Palët do të marrin të gjitha masat përkatëse për të parandaluar, kontrolluar dhe pakësuar sëmundjet e transmetuara nëpërmjet ujit, në kuadrin e sistemeve të administrimit të integruar të ujit me qëllim përdorimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, cilësisë së ujit që nuk rrezikon shëndetin publik dhe mbrojtjen e ekosistemeve të ujit.

2. Palët në veçanti do të marrin masat përkatëse me qëllim sigurimin të:

(a) furnizimit adekuat me ujë të pijshëm të shëndetshëm, që nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe substanca, të cilat, në vartësi të numrit apo përqëndrimet e tyre, përbëjnë një rrezik potencial për shëndetin publik. Kjo do të përfshijë mbrojtjen e burimeve ujore, të cilat janë përdorur si burime për ujë të pijshëm, trajtimin e ujit dhe vendosjen, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kolektive;

(b) sanitet të përshtatshëm, të një standardi që, në mënyrë efikase, mbron shëndetin publik dhe mjedisin. Kjo do të bëhet veçanërisht nëpërmjet vendosjes, përmirësimit dhe mirëmbajtjes të sistemeve kolektive;

(c) mbrojtje efektive të pasurive ujore që përdoren si burime të ujit të pijshëm, dhe ekosistemeve të lidhura me to, nga ndotja prej shkaqeve të tjera, duke përfshirë bujqësinë, industrinë dhe shkarkime të tjera si ato të substancave të rrezikshme. Kjo do të ndihmojë në pakësimin efektiv dhe eliminimin e shkarkimeve apo çlirimit të substancave që gjykohet të jenë të rrezikshme për shëndetin publik dhe ekosistemet e ujit;

(d) mbrojtje e mjaftueshme për shëndetin publik nga sëmundjet që transmetohen nëpërmjet ujit të përdorur për qëllime shplodhjeje, nga përdorimi i ujit për akuakulturë, nga uji ku kultivohen molusqet ose prej të cilave ato janë nxjerrë, nga përdorimi i ujërave të ndotura për vaditje ose nga përdorimi i llumit të ujërave të zeza në bujqësi apo akuakulturë;

(e) sisteme efektive për monitorimin e situatave që besohet se rezultojnë prej epidemive ose incidenteve të shkaktuara nga sëmundje që lidhen me ujin.

3. Referencat pasuese në këtë Protokoll për "ujin e pijshëm" dhe "sanitetin" janë për ujin e pijshëm dhe sanitetin që kërkohen të plotësohen sipas paragrafit 2 të këtij neni.

4. Palët do t'i bazojnë të gjitha këto masa në vlerësimin e çdo mase të propozuar sipas gjithë implikimeve që ajo shkakton, duke inkluduar përfitimet, disavantazhet dhe kostot për:

(a) shëndetin publik;

(b) resurset ujore; dhe

(c) zhvillimin e qëndrueshëm,

i cili merr në konsideratë dallimin e ndikimeve të reja të çdo masë të propozuar për mjedise të ndryshme.

5. Palët do të ndërmarrin të gjitha veprimet përkatëse për të krijuar kuadrin ligjor, administrativ dhe ekonomik, që është i qëndrueshëm dhe bën të mundur që brenda këtij kuadri, publiku, sektorët privatë dhe vullnetarë mund të japin kontributin e tyre për përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe për parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet ujit.

6. Palët do t'u kërkojnë autoriteteve publike që duhet të ndërmarrin aksione ose aprovojnë ndërmarrjen e tyre nga të tjerët dhe që mund të kenë një impakt të rëndësishëm në mjedisin ujor brenda kuadrit të këtij Protokolli, të marrin në konsideratë ndikimin potencial të këtyre veprimeve në shëndetin publik.

7. Kur një Palë është pjesëtare në Konventën mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar, plotësimi nga autoritetet publike të asaj Pale, sipas kërkesave të kësaj Konvente në lidhje me një aksion të propozuar, do të bëhet në përputhje me kërkesat e paragrafit 6 të këtij neni në lidhje me këtë aksion.

8. Kushtet e këtij Protokolli nuk duhet të prekin të drejtat dhe detyrimet e ndonjë Pale në këtë Protokoll që rrjedhin nga Konventa ose marrëveshje ndërkombëtare ekzistuese, përveç atëhere kur kërkesat në këtë Protokoll janë më bindëse sesa kërkesat korresponduese në konventa ose në

marrëveshjet e tjera ndërkombëtare ekzistuese.

Neni 5
Principet dhe qëndrimet

Në marrjen e masave për implementimin e këtij Protokolli, Palët do të udhëhiqen në veçanti nga principet dhe qëndrimet që vijojnë:

(a) Principi i parandalimit, sipas të cilit aksioni për të parandaluar, kontrolluar apo reduktuar sëmundjet që transmetohen nëpërmjet ujit, nuk do të spostohet në kohë, bazuar në atë që kërkimet shkencore nuk kanë provuar plotësisht një lidhje shkakësore midis faktorit në një anë dhe kontributit potencial të këtij faktori për përhapjen e sëmundjeve transmetuar me ujë dhe/ose impakteve ndërkufitare në anën tjetër.

(b) Principi ndotësi-paguan, sipas të cilit kostot e parandalimit, kontrollit dhe reduktimit të ndotjes duhet të mbulohen nga ndotësi.

(c) Shtetet, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe principet e ligjit ndërkombëtar, kanë të drejtën sovrane të shfrytëzojnë resurset e tyre në zbatim të politikave të tyre të zhvillimit dhe mjedisor dhe përgjegjësinë për të siguruar që aktivitetet nën juridiksionin ose kontrollin e tyre nuk shkaktojnë dëme në mjedisin e shteteve të tjera ose të zonave përtej limiteve të juridiksionit kombëtar.

(d) Resurset ujore do të administrohen në mënyrë të tillë që të plotësohen nevojat e gjeneratave të tanishme, pa kompromentuar aftësinë e gjeneratave të ardhshme për plotësimin e nevojave të tyre.

(e) Duhet të ndërmerren aksione parandaluese për shmangien e shpërthimeve epidemike dhe incidenteve të sëmundjeve të shkaktuara nga uji dhe të mbrohen resurset ujore që përdoren si burime të ujit të pijshëm, sepse të tilla aksione luftojnë rrezikun në mënyrë efikase dhe mund të jenë me kosto më efektive sesa mjekimi i këtyre sëmundjeve.

(f) Duhet të ndërmerren aksione për menaxhimin e burimeve ujore në nivelet më të ulta administrative.

(g) Uji ka vlera sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe duhet menaxhuar për të realizuar kombinimin më të pranueshëm dhe të qëndrueshëm të këtyre vlerave.

(h) Duhet të promovohet shfrytëzimi efikas i ujit nëpërmjet instrumenteve ekonomike dhe rritjes së ndërgjegjësimit të popullatës.

(i) Ndër të tjera, është i domosdoshëm aksesi në informacion dhe pjesëmarrja e publikut në vendim-marrje përsa i përket ujit dhe shëndetit, në mënyrë që të rritet cilësia dhe implementimi i zbatimit të vendimeve, të ndërtohet ndërgjegjësimi i publikut për problemet, t'i jepet publikut mundësia për të shprehur shqetësimet e tij dhe të mundësojë autoritetet publike të marrin në konsideratë shqetësimet e publikut. Këtij aksesi dhe pjesëmarrjeje duhet t'i shtohet aksesi përkatës për shqyrtimin juridik dhe administrativ të vendimeve të rëndësishme.

(j) Resurset ujore duhet të administrohen, sa të jetë e mundur, në një mënyrë të integruar në bazë të zonës së pellgut ujëmbledhës, me qëllim që të lidhet zhvillimi social dhe ekonomik me mbrojtjen e ekosistemit natyror dhe menaxhimin e resurseve përkatëse ujore sipas masave rregulluese që lidhen me aspekte të tjera mjedisore. Një qëndrim i tillë i integruar duhet zbatuar përgjatë të gjithë zonës së pellgut ujëmbledhës, është apo jo ndërkufitar, duke përfshirë ujërat bregdetare që lidhen me të, të gjithë akuiferin nëntokësor ose pjesët e rëndësishme të zonës së pellgut ujëmbledhës ose akuiferit nëntokësor.

(k) Duhet të merret në konsideratë mbrojtja e njerëzve që janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj sëmundjeve që transmetohen me ujin.

(l) Për të gjithë popullatën duhet të sigurohet akses i barabartë ndaj ujit, adekuat përsa i përket sasisë dhe cilësisë, veçanërisht për ata që vuajnë nga disavantazhe ose përjashtime sociale.

(m) Personat fizikë dhe juridikë, si dhe institucionet në sektorin publik dhe atë privat si kontraparte për të drejtat e tyre dhe për ujin në sektorin privat dhe atë publik, duhet të kontribuojnë në mbrojtjen e mjediseve ujore dhe konservimin e pasurive ujore, dhe

(n) Në zbatimin e këtij Protokolli, rëndësi e veçantë i duhet kushtuar problemeve lokale, nevojave dhe dijeve.

Neni 6
Objektivat dhe afatet

1. Në mënyrë që të arrihen objektivat e këtij Protokolli, Palët do të synojnë këto qëllime:

(a) Akses për ujë të pijshëm për çdo njeri;

(b) Sigurim i kushteve higjienike për çdo njeri në kuadrin e sistemeve të integruara të menaxhimit të ujit, që nuk rrezikojnë shëndetin human dhe mbrojtjen e ekosistemeve të ujit.

2. Për këto qëllime, secila Palë duhet të vendosë dhe publikojë objektivat kombëtare dhe/ose lokale për standardet dhe nivelet që duhen arritur ose mbajtjen e një niveli të lartë të mbrojtjes ndaj sëmundjeve që transmetohen me ujin. Këto objektiva duhet të rishikohen në mënyrë periodike. Në kryerjen e këtyre, ato do të bëjnë parashikime për pjesëmarrjen e publikut brenda një kuadri transparent dhe duhet të sigurojnë që është marrë në konsideratë rezultati i pjesëmarrjes së publikut.

Me përjashtim të rasteve ku rrethanat kombëtare apo lokale i bëjnë ato të pamundura për parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve të transmetuara nëpërmjet ujit, objektivat duhet të mbulojnë midis të tjerave:

(a) cilësinë e ujit të pijshëm, duke marrë në konsideratë Udhëzimet e OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm;

(b) pakësimin e numrit të shpërthimeve epidemike dhe incidenteve të sëmundjeve transmetuar nëpërmjet ujit;

(c) territorin ose madhësinë apo grupet e popullatës, së cilës duhet t'i shërbehet me sisteme kolektive për furnizimin me ujë të pijshëm, ose ku furnizimi me ujë të pijshëm duhet të përmirësohet me mënyra të tjera;

(d) territorin ose madhësinë apo grupet e popullatës, së cilës duhet t'i shërbehet me sistemet kolektive, apo ku kushtet higjienike duhen përmirësuar;

(e) nivelet e efektshmërisë që duhet të arrihen në këto sisteme kolektive dhe mënyrave të tjera të furnizimit me ujë dhe të gjendjes higjienike;

(f) aplikimi i praktikave të mirënjohura për menaxhimin e furnizimit me ujë dhe sanitetit, duke inkluduar mbrojtjen e ujërave që përdoren si burime për ujë të pijshëm;

(g) gjendjen e shkarkimeve të:

(i) ujërave të ndotura të patrajtuara; dhe

(ii) plotat e ujërave të bardha të patrajtuara,

nga sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotura, brenda sferës së këtij Protokolli;

(h) cilësia e shkarkimeve të ujërave të ndotura nga instalimet e trajtimeve të ujërave të ndotura në kuadrin e këtij Protokolli;

(i) përpunimi ose ripërdorimi i llumit nga trajtimi i ujërave të zeza nga sistemet kolektive të sanitetit ose instalime të tjera sanitare dhe cilësia e ujërave të ndotura që përdoret për qëllime vaditjeje, duke marrë në konsideratë Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin për përdorimin e sigurt të ujërave të zeza dhe ekskrementeve në bujqësi dhe akuakulturë;

(j) cilësia e ujërave që do përdoren si burime për ujë të pijshën, ato që në përgjithësi përdoren për banjo ose për akuakulturë, si dhe për prodhimin e molusqeve;

(k) aplikimi i praktikave të njohura mirë për menaxhimin e ujërave me qarkullim të mbyllur të destinuara në përgjithësi për banjo (pishina);

(l) identifikimi dhe rehabilitimi i vendeve veçanërisht të kontaminuara të cilat ndikojnë negativisht në ujëra në kuadrin e këtij Protokolli dhe që kërcënojnë shtimin e sëmundjeve transmetuar nëpërmjet ujit;

(m) efektiviteti i sistemeve për menaxhimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe përdorimin e resurseve ujore, duke inkluduar aplikimin e praktikave të mira në kontrollin nga ndotja nga burime të të gjitha llojeve;

(n) frekuenca e publikimit të informacionit mbi cilësinë e ujit të pijshëm të furnizuar dhe ujërave të tjera të përcaktuara në këtë paragraf, në intervalet midis publikimit të informacionit në nenin 7 paragrafi 2.

3. Brenda dy viteve të bërjes Palë, çdo Palë duhet të vendosë dhe publikojë normativat e referuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe masat për arritjen e tyre.

4. Atje ku është parashikuar një proces i gjatë implementimi për arritjen e një objektivi duhet

të vendosen objektiva të ndërmjetme.

5. Në mënyrë që të promovohet arritja e objektivave të referuara në paragrafin 2 të këtij artikulli, Palët:

(a) do të vendosin rregullimet kombëtare ose lokale për koordinimin midis autoriteteve të tyre kompetente;

(b) do të zhvillojnë planet e menaxhimit të ujit në kontekstin ndërkufitar, kombëtar dhe/ose lokal, në bazë të zonave të pellgut ujëmbledhës ose ujërave nëntokësore. Për arritjen e tyre, ato duhet të bëjnë parashikime për pjesëmarrjen publike, në kuadrin e transparencës, dhe duhet të sigurojnë se është marrë në konsideratë rezultati i pjesëmarrjes publike. Plane të tilla duhet të inkludohen në plane, programe ose dokumente të tjera, të cilat janë përpiluar për qëllime të tjera, duke siguruar që ato të mundësojnë publikun të shohë qartë propozimet për arritjen e qëllimeve të referuara në këtë artikull dhe afatet kohore respektive;

(c) do të vendosin dhe mbajnë një kuadër ligjor dhe institucional për monitorimin dhe detyrimin e zbatimit të standardeve për cilësinë e ujit të pijshëm;

(d) do të vendosin dhe mbajnë aranxhimet, kur është e përshtatshme, ato legale dhe institucionale, për monitorimin, promovimin e arritjeve dhe, kur është e nevojshme, imponimin e standardeve dhe niveleve të tjera për të cilat janë vendosur objektiva që referohen në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 7
Rishikimi dhe vlerësimi i progresit

1. Çdo Palë duhet të mbledhë dhe të vlerësojë të dhëna mbi:

(a) progresin e tyre në arritjen e objektivave të referuara në nenin 6 paragrafi 2;

(b) indikatorët që janë përcaktuar për të treguar se sa ky progres ka kontribuar në drejtim të parandalimit, kontrollit ose reduktimit të sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet ujit.

2. Secila Palë duhet të publikojë periodikisht rezultatet e mbledhjes dhe vlerësimit të të dhënave. Frekuenca e botimeve të tilla duhet të vendosen nga takimi i Palëve.

3. Secila Palë duhet të sigurojë që rezultatet e analizave të mostrave të ujit dhe shkarkimeve, të kryera për qëllime të mbledhjes së të dhënave, janë disponibël për publikun.

4. Bazuar në mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave, çdo Palë duhet të rishikojë periodikisht progresin e bërë në arritjen e objektivave të referuara në nenin 6 paragrafi 2 dhe të publikojë një vlerësim të këtij progresi. Frekuenca e këtyre vëzhgimeve duhet të vendoset nga takimi i Palëve. Pa paragjykuar për mundësinë e më tepër vëzhgimeve, sipas nenit 6 paragrafi 2 përmbledhja në këtë paragraf duhet të inkludojë një pasqyrë të objektivave të referuara në nenin 6 paragrafin 2, me synim përmirësimin e objektivave në dritën e njohurive teknike dhe shkencore.

5. Çdo Palë, referuar artikulli 17, do të sigurojë për sekretariatin një raport përmbledhës të të dhënave të mbledhura dhe vlerësimit të progresit të arritur për qarkullim në Palët e tjera. Raporte të tilla do të jenë në përputhje me udhëzimet e vendosura nga Takimi i Palëve. Këto udhëzime duhet të sigurojnë që Palët do të përdorin për këtë qëllim raporte që pasqyrojnë informacionin përkatës të përgatitur për forume të tjera internacionale.

6. Takimi i Palëve do të vlerësojë progresin në implementimin e këtij Protokolli, bazuar në raporte të tilla përmbledhëse.

Neni 8
Sistemet e përgjigjes

1. Çdo Palë do të sigurojë që:

(a) janë vendosur, përmirësuar ose ruajtur sistemet e përgjithshme të survejimit, nacional dhe/ose lokal dhe sistemet e paralajmërimit të shpejtë, të cilat do të:

(i) identifikojnë shpërthimet ose incidentët e sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet ujit ose kërcënime nga këto shpërthime apo incidentet, duke inkluduar ato që rezultojnë nga incidentet prej ndotjes së ujit ose ndodhi ekstreme nga moti;

(ii) të japin njoftim të shpejtë dhe të qartë për autoritetet përkatëse publike rreth shpërthimeve të tilla, incidenteve ose kërcënimeve;

(iii) në rastin e ndonjë kërcënimi të dukshëm për shëndetin publik nga sëmundjet që transmetohen nëpërmjet ujit, t'i shpërndahet asaj pjese të publikut që mund të preket, gjithë informacioni që disponohet nga autoritetet publike dhe që mund të ndihmojë publikun të parandalojë ose zbusë rrezikun;

(iv) të bëjë rekomandimet për autoritetet publike përkatëse dhe, kur është e domosdoshme, publikut për aksione parandaluese dhe rregulluese;

(b) planet kombëtare dhe lokale për t'iu përgjigjur shpërthimeve, incidenteve dhe rreziqeve të tilla të jenë të përgatitura në kohën e duhur;

(c) autoritetet publike përkatëse të kenë kapacitetet e nevojshme për t'iu përgjigjur shpërthimeve, incidenteve ose rreziqeve të tilla në përputhje me planet përkatëse të urgjencës.

2. Sistemet e mbikëqyrjes dhe të paralajmërimit të shpejtë, planet e emergjencës dhe kapacitetet e përgjigjes në lidhje me sëmundjet që transmetohen nëpërmjet ujit duhet të kombinohen me problemet e tjera.

3. Brenda tre vjetëve të bërjes Palë, secila Palë duhet të ketë vendosur sistemet e mbikëqyrjes dhe të paralajmërimit të hershëm, planet e emergjencës dhe kapacitetet e përgjigjes, referuar në paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 9

Ndërgjegjësimi i publikut, edukimi, trajnimi, kërkimi dhe zhvillimi e informacioni

1. Palët do të bëjnë hapa në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për:

(a) rëndësinë dhe lidhjet midis menaxhimit të ujit dhe shëndetit publik;

(b) të drejtave për ujë dhe detyrimeve përkatëse sipas ligjit për personat fizikë dhe juridikë, në sektorin publik apo privat, si dhe obligimeve morale për të kontribuar në mbrojtjen e mjedisit, të ujit dhe ruajtjen e burimeve ujore.

2. Palët do të promovojnë:

(a) kuptimin e aspekteve të shëndetit publik, nga ata që janë përgjegjës për menaxhimin e ujit, furnizimin me ujë dhe sanitetin; dhe

(b) kuptimin e principeve bazë të menaxhimit të ujit, furnizimit me ujë dhe sanitet nga ata që janë përgjegjës për shëndetin publik.

3. Palët do të inkurajojnë:

(a) kërkimet për zhvillimin e mënyrave me kosto efektive dhe teknikave për parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve që transmetohen përmes ujit;

(b) zhvillimin e sistemit të informacionit të integruar për përpunimin e informacionit rreth tendencave afatgjata, problemeve aktuale dhe atyre të mëparshme, si dhe zgjidhjeve të suksesshme për ato në fushën e ujit dhe të shëndetit, sigurimin e një informacioni të tillë për autoritetet kompetente.

Neni 10

Informimi i publikut

1. Si shtesë në kuadrin e kërkesave të këtij Protokolli për Palët në publikimin e dokumenteve ose të informacioneve specifike, çdo Palë duhet të bëjë hapa brenda kuadrit legal që të mundësojë disponibilitetin për publikun të një informacioni të tillë dhe, kur është e arsyeshme, të informojnë publikun për diskutimin e:

(a) vendosjes së objektivave dhe afateve për arritjen e synimeve të caktuara dhe zhvillimin e planeve për menaxhimin e ujit, në përputhje me nenin 6;

(b) vendosjes, përmirësimit ose mirëmbajtjes e mbikqyrjes dhe sistemit të hershëm të lajmërimit dhe planeve të emergjencës, në përputhje me nenin 8;

(c) promovimit për ndërgjegjësimin e publikut, edukimin, trajnimin, kërkimin, zhvillimin dhe informacionit, në pajtim me nenin 9.

2. Çdo Palë do të sigurojë që autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacione të tjera përkatëse për implementimin e këtij Protokolli, t'i bëjë këto informacione disponibël brenda një kohe të arsyeshme për publikun, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar.

3. Palët do të sigurojnë që informacioni referuar në nenin 7 paragrafi 4 dhe paragrafi 1 i këtij neni do të jetë disponibël për publikun në çdo kohë pa pagesë dhe do të sigurojë pjesëtarëve të

publikut për marrjen nga Palët, me pagesë me çmime të arsyeshme, të kopjeve të informacioneve të tilla.

4. Asgjë në këtë Protokoll nuk detyron një autoritet publik të publikojë informacionin ose ta bëjë atë disponibël për publikun nëse:

(a) autoriteti Publik nuk ka informacion;

(b) kërkesa për informacion është e paarsyeshme ose e formuluar në mënyrë të përgjithshme; ose

(c) informacioni i përket materialit në proces ose lidhet me komunikime të brendshme të autoriteteve publike, kur një përjashtim i tillë është përshkruar nga ligjet e vendit ose praktika doganore, duke pasur parasysh interesat publike të ofruara nga informacioni.

5. Ky Protokoll nuk kërkon që një autoritet publik të publikojë informacion ose ta bëjë atë disponibël për publikun nëse ky informacion ndikon negativisht në:

(a) konfidencialitetin e procedurave të autoritetit publik, kur ky konfidencialitet është siguruar me ligjet e vendit;

(b) marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare ose sigurimin publik;

(c) aktivitetin e drejtësisë, mundësinë e një personi për të patur një gjykim të drejtë ose mundësinë e autoritetit publik të hetojë një veprimtari të natyrës disiplinore ose kriminale;

(d) konfidencialitetin e informacionit komercial ose industrial, kur ky është i sanksionuar me ligj, në mënyrë që të mbrojë interesin legjitim ekonomik. Brenda këtij kuadri, informacionet përkatëse për shkarkimet dhe çlirimet që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit do të nxjerrin në dritë;

(e) të drejtat përkatëse intelektuale;

(f) konfidencialitetin e të dhënave personale dhe/ose dosjeve në lidhje me një person fizik, kur ky person nuk ka dhënë pëlqimin për nxjerrjen në dritë të informacionit për publikun, kur ky konfidencialitet është siguruar nga ligji i vendit;

(g) interesat e Palës së tretë, e cila ka furnizuar me informacionin e kërkuar pa qenë e obliguar legalisht dhe ku kjo Palë nuk lejon të bëjë publik materialin; ose

(h) mjedisi me të cilin është i lidhur informacioni, siç janë vendet e folenizimit të specieve të rralla.

Rastet e mosdhënies së informacionit, do të interpretohen në një mënyrë të kufizuar, duke marrë në konsideratë interesimet e publikut që lidhen me përdorimin e informacionit lidhur me emisione apo shkarkime në mjedis.

Neni 11

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Palët do të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë njëri - tjetrin:

(a) në veprimtari ndërkombëtare në mbështetje të objektivave të këtij Protokolli;

(b) sipas kërkesës, në implementimin e planeve lokale dhe kombëtare në zbatim të këtij Protokolli.

Neni 12

Aksione ndërkombëtare të përbashkëta dhe të koordinuara

Në zbatim të nenit 11 nënparagrafi (a), Palët duhet të promovojnë kooperim në veprimtari ndërkombëtare në lidhje me:

(a) zhvillimin e objektivave të përbashkëta, për të cilat është rënë dakord për çështjet që referohen në nenin 6, paragrafi 2;

(b) zhvillimin e indikatorëve për qëllimet e nenit 7 paragrafi 1 (b) për të treguar se deri ku aksionet e sëmundjeve që transmetohen nëpërmjet ujit kanë qenë të suksesshme në parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve të tilla;

(c) vendosjen e sistemeve të përbashkëta të koordinuara për sistemet e survejimit dhe alarmit të hershëm, planeve të emergjencës dhe kapaciteteve të përgjigjes si pjesë ose plotësim të sistemeve nacionale, të mbajtura në përputhje me nenin 8 për qëllime të masave ndaj shpërthimeve dhe incidenteve të sëmundjeve, që transmetohen përmes ujit, dhe kërcënimeve serioze të shpërthimeve apo incidenteve, veçanërisht nga uji i ndotur ose ndodhive të një moti ekstrem;

(d) ndihma reciproke në përgjigje të shpërthimeve dhe incidenteve të sëmundjeve që transmetohen përmes ujit dhe kërcënimeve të rrezikshme të shpërthimeve apo incidenteve, veçanërisht nga ndotjet e ujit apo ndodhi të një moti ekstrem;

(e) zhvillimi i sistemeve të informacionit të integruar dhe bankës së të dhënave, shkëmbim informacioni dhe këmbimet e eksperiencës dhe njohurive teknike e legale;

(f) njoftim i shpejtë dhe i qartë nga autoritet kompetente të një Pale me autoritet korresponduese të Palëve të tjera që mund të ndikohen nga:

(i) shpërthime dhe incidente të sëmundjeve që transmetohen përmes ujit, dhe

(ii) kërcënime të rrezikshme të shpërthimeve apo incidenteve të cilat janë identifikuar;

(g) shkëmbim të informacionit për mënyrat efikase të shpërndarjes në publik të informacionit për sëmundjet që transmetohen përmes ujit.

Neni 13

Bashkëpunimi në lidhje me ujërat ndërkufitare

1. Kur Palët kufizohen me të njëjtat ujëra ndërkufitare, për plotësimin e detyrimeve të tyre të tjera sipas neneve 11 dhe 12, ato do të kooperojnë dhe, kur të jetë e nevojshme, do të ndihmojnë njëra - tjetrën për të parandaluar, kontrolluar dhe pakësuar efektet e sëmundjeve që transmetohen përmes ujit. Veçanërisht ato do të:

(a) shkëmbejnë informacion dhe njohuritë për ujërat ndërkufitare dhe problemet e risqet që ato prezantojnë së bashku me Palët e tjera që ndajnë të njëjtat ujëra;

(b) përpiqen të vendosin me Palët e tjera që ndajnë të njëjtat ujëra ndërkufitare; planet e menaxhimit të përbashkëta ose të koordinuara të ujit, në pajtim me nenin 6 paragrafi 5 (b), sistemet e mbikëqyrjes, të njoftimit të hershëm dhe planet e emergjencës në pajtim me nenin 8 paragrafi 1, për t'iu përgjigjur shpërthimeve dhe incidenteve të sëmundjeve që transmetohen përmes ujit dhe kërcënimeve të rrezikshme nga këto episode, veçanërisht incidentet nga uji i ndotur ose ndodhitë e një moti të keq;

(c) bazuar në reciprocitetin dhe barazinë, miratojnë marrëveshjet ndërmjet tyre dhe rregulla të tjera, përsa i përket ujërave ndërkufitare për të eliminuar ndonjë kontradiktë, me principet bazë të këtij Protokolli dhe të përcaktojnë marrëdhëniet e tyre reciproke dhe drejtimet lidhur me qëllimet e këtij Protkolli;

(d) konsultojnë njëri-tjetrin, për kërkesa të njërit prej tyre, për çdo efekt negativ të rëndësishëm në shëndetin human që mund të përbëjë çdo sëmundje që transmetohet përmes ujit.

2. Kur Palët e interesuara janë Palë në Konventë, kooperimi dhe bashkëpunimi, për efektet ndërkufitare të sëmundjeve që transmetohen përmes ujit, të cilat kanë ndikim ndërkufitar, duhet të zhvillohet në pajtim me klauzolat e Konventës.

Neni 14

Mbështetja ndërkombëtare për aksione kombëtare

Kur kooperojnë dhe ndihmojnë njëri - tjetrin në implementimin e planeve lokale dhe kombëtare në vijim të nenit 11 nënparagrafi (b) Palët do të marrin, veçanërisht, në konsideratë mënyrat se si ato do të ndihmojnë për të promovuar:

(a) përgatitjen e planeve për menaxhimin e ujit në kontekstin ndërkufitar, kombëtar dhe/ose lokal dhe të skemave për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe sanitet;

(b) përmirësimin e formulimit të projekteve, sidomos projekteve për infrastrukturën, në zbatim të planeve dhe skemave të tilla, që lehtësojnë aksesin në burime financimi;

(c) ekzekutimin efikas të projketeve të tilla;

(d) vendosjen e sistemeve për vëzhgimin dhe njoftimin e hershëm, planeve të emergjencës dhe kapaciteteve të përgjigjes në lidhje me sëmundjet që transmetohen përmes ujit;

(e) përgatitjen e legjislacionit që nevojitet për të mbështetur implementimin e këtij Protokolli;

(f) edukimin dhe trajnimin e stafit teknik kryesor;

(g) kërkimin për zhvillimin e mënyrave dhe teknikave me kosto efektive për prevenimin, kontrollin dhe reduktimin e sëmundjeve që transmetohen përmes ujit;

(h) operimin e rrjeteve efektive për monitorimin dhe vlerësimin e kushteve dhe cilësisë së

shërbimeve që lidhen me ujin dhe zhvillimin e sistemeve të integruara dhe bankës së të dhënave;

(i) arritjen e sigurisë së cilësisë për monitorimin e aktiviteteve, përfshirë krahasimin midis laboratorëve.

Neni 15
Shqyrtimi i detyrimeve

Palët duhet të shqyrtojnë pajtimin e Palëve me klauzolat e këtij Protokolli, në bazë të rishikimeve dhe vlerësimeve të referuara në nenin 7. Rregullimet multilaterale të një natyre jo konfrontuese, jokritike dhe konsultative për shqyrtimin e detyrimeve duhet të përcaktohen nga Palët në takimin e tyre të parë. Këto rregullime duhet të lejojnë për një pjesëmarrje të përshtatshme të publikut.

Neni 16
Takimi i Palëve

1. Takimi i parë i Palëve duhet të mblidhet jo më vonë se tetëmbëdhjetë muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Protokolli.

Më pas, takimet e zakonshme do të mbahen në intervale të rregullta që do të përcaktohen nga Palët, por të paktën çdo tre muaj, veç rasteve kur janë të nevojshme aktivitete të tjera për arritjen e qëllimeve të paragrafit 2 të këtij neni. Palët mund të mbajnë një takim të jashtëzakonshëm, në qoftë se ato vendosin gjatë takimeve të zakonshme ose me kërkesën me shkrim të çdo Pale, duke siguruar që brenda gjashtë muajve që iu është komunikuar të gjitha Palëve, kërkesa të përkrahet së paku nga një e treta e Palëve.

2. Kur është e mundur, takimet e zakonshme të Palëve do të mbahen bashkë me takimet e Palëve në Konventë.

3. Në takimet e tyre, Palët do të mbajnë në shqyrtim të vazhdueshëm implementimin e këtij Protokolli, dhe për këtë qëllim do të:

(a) do të rishikojnë politikat për përpjekje metodologjike për parandalimin, kontrollin dhe pakësimin e sëmundjeve që transmetohen përmes ujit, të promovojnë afrimin e tyre dhe të forcojnë kooperimin ndërkombëtar dhe ndërkufitar në pajtim me nenin 11,12,13 dhe 14;

(b) do të vlerësojnë progresin në implementimin e këtij Protokolli, në bazë të informacionit të siguruar nga Palët në pajtim me udhëzimet e caktuara nga Takimi i Palëve. Këto udhëzime duhet të shmangin dublimin e përpjekjeve në raportimin e kërkesave;

(c) do të jenë të informuar me progresin e bërë në implementimin e Konventës;

(d) do të shkëmbejnë informacion nga Takimet e Palëve në Konventë dhe të marrin në konsideratë mundësitë për aksione të përbashkëta me të;

(e) do të kërkojnë, kur është e mundur, shërbimet e organizmave përkatëse të Komisionit Ekonomik për Europën dhe Komitetit Rajonal për Europën të Organizatës Botërore të Shëndetësisë;

(f) do të përcaktojnë modalitetet për pjesëmarrjen e organizmave të tjera kompetente ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare, në të gjitha takimet dhe aktivitetet e tjera për arritjen e qëllimeve të këtij Protokolli;

(g) do të marrin në konsideratë nevojën për parashikime të mëtejshme mbi të drejtën për informacion, pjesëmarrjen publike në vendim-marrje dhe të drejtën e publikut në gjykim dhe shqyrtim administrativ brenda kuadrit të këtij Protokolli, në dritën e eksperiencës së fituar për këto probleme në forume të tjera ndërkombëtare;

(h) do të përcaktojnë një program pune, duke përfshirë projektet që do të kryhen në lidhje me këtë Protokoll dhe Konventën dhe të ngrejë organizmat që nevojiten për implementimin e këtij programi pune;

(i) do të marrin në konsideratë dhe adaptojë udhëzimet dhe rekomandimet që promovojnë implementimin e parashikimeve të këtij Protokolli;

(j) do të marrin parasysh në takimin e parë dhe me konsensus, miratojnë rregullat e procedurës të takimeve. Këto rregulla duhet të përfshijnë klauzola për të promovuar një kooperim të harmonishëm me takimet e Palëve me Konventën;

(k) do të marrin në konsideratë dhe miratojnë propozime për amendamente të këtij Protokolli;

(l) do të marrin parasysh dhe ndërmarrin çdo aksion shtesë që mund të kërkohet për arritjen e

qëllimeve të këtij Protokolli.

Neni 17
Sekretariati

1. Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën dhe Drejtori Rajonal i Zyrës Rajonale për Europën i Organizatës Botërore të Shëndetësisë do të kryejë shërbimet e sekretariatit për këtë Protokoll si vijon:

(a) Thërret dhe përgatit takimet e Palëve.

(b) Transmeton tek Palët raporte dhe informacione të tjera të marra në pajtim me klauzolat e këtij Protokolli.

(c) Kryen funksione të tjera të përcaktuara nga takimi i Palëve në bazë të burimeve disponibël.

2. Sekretariati Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën dhe Drejtori Rajonal i Zyrës Rajonale për Europën i Organizatës Botërore të Shëndetësisë:

(a) do të përcaktojnë me hollësi detyrat e secilit në një Memorandum Mirëkuptimi dhe do të informojnë respektivisht në Takimin e Palëve;

(b) do të raportojnë në mbledhjen e Palëve për elementet dhe modalitetet për kryerjen e programeve të punës referuar nenit 16 paragrafi 3.

Neni 18
Amendamente në Protokoll

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente në këtë Protokoll.

2. Propozimet për amendamente në këtë Protokoll duhet të merren në konsideratë në takimet e Palëve.

3. Teksti i çdo amendamenti të propozuar në këtë Protokoll duhet të paraqitet me shkrim në sekretariat, i cili komunikon me të gjitha Palët, së paku nëntëdhjetë ditë përpara takimit që është caktuar për miratim.

4. Çdo amendament në këtë Protokoll do të miratohet me konsensusin e përfaqësuesve të Palëve prezent në takim. Amendamenti i miratuar duhet të komunikohet nga sekretariati në Sekretari, i cili duhet ta dërgojë në të gjitha Palët për pranimin nga ana e tyre. Amendamenti hyn në forcë për Palët që e kanë pranuar atë, në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën dy të tretat e këtyre e Palëve kanë depozituar në Sekretari instrumentet e tyre të pranimit të amendamentit. Amendamenti për çdo Palë tjetër do të hyjë në forcë në ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën Pala ka depozituar instrumentet e saj të pranimit të amendamentit.

Neni 19
E drejta për të votuar

1. Me përjashtim të asaj çka është parashikuar në paragrafin 2 të këtij neni, çdo Palë duhet të ketë një votë.

2. Organizatat ekonomike rajonale të integruara për çështjet brenda kompetencave të tyre, duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar me një numër votash të barabarta me numrin e anëtarëve të shteteve që janë Palë. Këto organizata nuk mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar në qoftë se e ushtrojnë anëtarët e Shtetit të tyre dhe e kundërta.

Neni 20
Zgjidhja e konflikteve

1. Në qoftë se lind një konflikt midis dy ose më shumë Palëve për interpretimin ose aplikimin e këtij Protokolli, ato duhet të kërkojnë një zgjidhje me negociata ose me ndonjë mënyrë tjetër të zgjidhjes së konfliktit të pranueshme për Palët në konflikt.

2. Kur nënshkruhet, ratifikohet, pranohet, aprovohet ky Protokoll, ose në çdo kohë më vonë, çdo Palë duhet të deklarojë me shkrim në Sekretari që, për një konflikt të pazgjidhur në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, ajo pranon një nga mënyrat që pasojnë për zgjidhjen e konfliktit si detyrim

në lidhje me çdo Palë që pranon të njëjtin obligim:

(a) kur Palët janë Palë në Konventë dhe kanë pranuar një detyrim në lidhje me njëri - tjetrin ose të dy mënyrat e zgjidhjes së konfliktit të parashikuara në Konventë, zgjidhja e konfliktit bëhet në pajtim me parashikimet e Konventës për zgjidhjen e konflikteve që lindin në lidhje me Konventën;

(b) në çdo rast tjetër, paraqitja e konfliktit do të bëhet në Trupin Gjykues Ndërkombëtar, në qoftë se Palët bien dakord për arbitrazh ose forma të tjera të zgjidhjes së konfliktit.

Neni 21

Nënshkrimi

Ky Protokoll do të hapet për nënshkrim në Londër më 17 qershor 1999 me rastin e Konferencës së Tretë të Ministrave për Mjedisin dhe Shëndetin dhe paskëtaj në Qendrën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork deri më 18 qershor 2000, për Shtetet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, për Shtetet anëtare të Komunitetit Rajonal për Europë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për Shtetet që kanë një status konsultativ me Komisionin Ekonomik për Europën në pajtim me paragrafin 8 të Rezolutës 36 (IV) të Këshillit Social dhe Ekonomik të 28 Marsit 1947 dhe për organizatat e integrimit ekonomik rajonal të përbëra nga anëtarë të shteteve sovrane të Komisionit Ekonomik për Europën ose anëtare të Komitetit Rajonal për Europën të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, tek të cilat Shtetet anëtare i kanë transferuar kompetencat mbi çështjet që rregullohen nga ky Protokoll, duke përfshirë kompetencat për të hyrë në tratativa për këto probleme.

Neni 22

Ratifikimi, pranimi, aprovimi dhe hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll do të jetë subjekt për ratifikim, pranim ose aprovim nga Shtetet nënshkruese që janë Palë dhe organizatat ekonomike të integruara rajonale.

2. Ky Protokoll do të jetë i hapur për hyrjen në fuqi nga Shtetet dhe organizatat e referuara në nenin 21.

3. Çdo organizatë, referuar në nenin 21 që bëhet Palë, pa qenë Palë asnjë nga Shtetet anëtare të saj, duhet të jetë e lidhur me të gjitha obligimet e këtij Protokolli. Në rastin e organizatave të tilla, ku një apo më shumë nga Shtetet anëtare janë Palë, Organizata dhe Shtetet anëtare do të vendosin për përgjegjësitë e tyre respektive për kryerjen e obligimeve që kanë sipas këtij Protokolli. Në raste të tilla, Organizata e Shteteve anëtare nuk do t'iu jepet e drejta e ushtrimit, të drejtave sipas këtij Protokolli njëkohësisht.

4. Në instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes në fuqi, organizatat ekonomike të integruara rajonale, referuar në nenin 21 duhet të deklarojnë shkallën e kompetencave të tyre në lidhje me çështjet që përmban ky Protokoll. Këto organizata duhet të informojnë, gjithashtu, Sekretarinë për çdo modifikim të rëndësishëm në shkallën e kompetencave të tyre.

5. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes në fuqi duhet të depozitohen në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Neni 23

Hyrja në forcë

1. Ky Protokoll do të hyjë në forcë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të të gjashtëmbëdhjetit instrument të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes në fuqi.

2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, instrumenti i depozituar nga çdo organizatë ekonomike të integruar rajonale nuk do të llogaritet si shtesë pas atyre të depozituara nga Shteti anëtar i kësaj organizate.

3. Për çdo Shtet ose organizatë refrruar në nenin 21 që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Protokoll ose e miraton pas depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes në forcë, Protokolli do të hyjë në forcë në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit prej shteteve ose dhe organizatave të tilla.

Neni 24
Tërheqja

Në çdo kohë, pas tri viteve ku ky Protokoll ka hyrë në forcë për një Palë, ajo Palë mund të tërhiqet nga Protokolli duke dhënë njoftim me shkrim në Sekretari. Kjo tërheqje do të ketë efekt në ditën e nëntëdhjetë pas marrjes nga Sekretaria.

Neni 25
Sekretaria

Sekretaria e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mund të veprojë si Sekretari për këtë Protokoll.

Neni 26
Tekstet origjinale

Origjinali i këtij Protokolli, nga të cilat tekstet anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe rusisht janë barazisht autentike, do të depozitohen në Sekretarinë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të nënshkruesve të mëposhtëm dhe të autorizuar për këtë, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Londër, ditën e 18 të qershorit të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë.

Nevoja për një iniciativë ndërkombëtare mbi ujin dhe shëndetin u identifikua nga Komiteti Europian për Mjedisin dhe Shëndetin (EEHC) në 1996.

Një konsultim ekspertësh u mbajt më 1997 nga OBSH-ja, e cila rekomandoi një inciativë të një natyre detyruese. Gjithashtu më 1997, EEHC ftoi OBSH-në dhe Komisionin Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën (UN/ECE) që të përgatisnin propozimet për Konferencën e Tretë Ministeriale për Mjedisin dhe Shëndetin, dhe Hungaria pranoi të jetë vendi drejtues. Në 1997 u formua një Grup për përgatitjen e draftit të projektit. Në një konsultim ndërshtetëror të përfaqësuesve të Shteteve Anëtare në Rajonin Europian të OBSH-së, UN/ECE dhe Komisionit Europian, të mbajtur më 1998, u vendos që të përgatitet një Protokoll për Konventën e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara UN/ECE për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Rrjedhave Ujore Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare (1992). U mbajtën dy takime ndërqeveritare për të përfunduar tekstin, secili i paraprirë nga takimet me grupin e përgatitjes së draftprojektit, duke inkluduar edhe organizata joqeveritare. Një monografi mbi ujin dhe shëndetin, e përgatitur nga Agjencia Europiane për Mjedisin, është disponibël si një dokument bazë.

Përveç burimeve të siguruara nga UN/ECE, OBSH-ja falenderon thellësisht mbështetjen nga Qeveria Hungareze dhe Agjencia Europiane e Mjedisit, dhe kontributin e dhënë nga përfaqësuesit e Shteteve Anëtare dhe organizatat të cilat morën pjesë në grupin e përgatitjes së draftit të projektit për Protokollin.